



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 87, Datë 09.05.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “H.K. HEC GRABOVA 2” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 996/1 prot., datë 08.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “H.K HEC GRABOVA 2” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996 prot., datë 25.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Grabova 2, i cili përbëhet nga HEC Grabova 2/1 dhe HEC Grabova 2/2, me kapacitet prodhues 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, por sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores së licencimit, shuma që duhet të paguajë rezulton më e vogël se ajo e paguar nga shoqëria, ndaj në vijim do të bëhen sistemimet përkatëse me departamentin e financës.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “H.K GRABOVA 2” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në mbështetje të Rregullores dhe në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c” si dhe për pikën 2, gërmat “a”, “d” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjëndjes gjyqësore nga Drejtoria e Burgjeve për administratoren tjetër Znj. Aurela D.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”:** Referuar vlerës totale të investimit përcaktuar në kontratën e koncensionit, aplikuesi duhet të dokumentojë në ERE mbështetjen financiare për vlerën e pambuluar nga ky investimit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE Akt-Marrëveshjen me nr. 420 rep., nr. 204 kol., datë 15.03.2018, të ndryshuar me Deklaratë Noteriale nr. 1094 rep, nr. 521 kol., datë 14.06.2019. Në lidhje me kontratën me nr. 1755 rep., nr. 599 kol., datë 16.07.2021 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë dhe shoqërisë “H.K. HEC Grabova 2”, do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE informacion nëse është pajisur me lejet përkatëse brenda afateve të vendosura në Marrëveshje.
- **gërma “c”:** Shoqëria ka depozituar në ERE rimiratimin në parim si e tillë do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.
- **gërma “e”:** Shoqëria ka depozituar VNM Paraprake e cila ka përfunduar afatin e vlefshmërisë së saj, si e tillë do t’i kërkohet të depozitojë informacion në ERE nëse ka nisur punimet brenda datës së vlefshmërisë së VNM-së.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H.K. HEC GRABOVA 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Grabova 2/1 dhe HEC Grabova 2/2, me kapacitet total të instaluar 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI